



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 334/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3600 (tremijegjashtëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik Aleanca Kosova e Re, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik PDK, i ka mbuluar posterat e subjektit politik AKR, duke i vendosur posterat e kandidatit të saj për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 06.12.2010, nga subjekti politik AKR, në të cilën theksohet se në Sheshin Nëna Terezë anëtarët e subjektit politik PDK i kanë mbuluar posterat e subjektit politik AKR, duke i vendosur posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga rradhët e PDK Blerand Stavileci mbi ato të kandidatëve të Koalicionit për Kosovë të Re Behgjet Pacolli, Myzejene Selmani, Ibrahim Gashi dhe Shaip Vitija, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi nga Sheshi Nëna Terezë në Prishtinë si dëshmi, në të cilën shihet qartë posterat e kandidatit Blerand Stavileci nga rradhët e subjektit politik PDK, është i vendosur mbi posterat e kandidatëve për deputet nga rradhët e Koalicionit për Kosovë të Re.

Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 06.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.12.2010, gjerë në ora 16:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Neni 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterit i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës Blerand Stavileci, nga radhët e subjektit politik PDK, është vendosur mbi posterat e kandidatëve për deputet nga rradhët e Koalicionit për

Kosovën e Re, nga kjo arsye e më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur dhe në pajtim më dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 334/2010 më datën 08.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

